



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E
TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E ANKESAVE DHE HARMONIZIMIT

Nr. 1348/1 prot.

Tiranë më 29.05.2024

Lënda: Dhënie mendimi mbi projektvendim.

MINISTRISË SË BRENDSHME
(DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË GJENDJES CIVILE)

Tiranë

Në përgjigje të shkresës suaj nr. 5766/1 prot., datë 21.05.2024, administruar me tonën me nr. 1348 prot., datë 23.05.2024, përmes së cilës dërgohet për mendim projektvendimi “Për përcaktimin e procedurës së krijimit të regjistrit elektronik, bazë të dhënash shtetërore, kriteret, mënyra dhe dokumentacioni për kërkesën për ID digjitale të rezidentit elektronik, përfshirë përpunimin, vlerësimin dhe miratimin e kërkesave”, së bashku me relacionin shpjegues, më poshtë gjeni vlerësimin e Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, “Zyra e Komisionerit”).

Nga shqyrtimi i projektvendimit dhe relacionit shoqërues, konstatohet se krijimi i regjistrit elektronik, bazë të dhënash shtetërore “E-Rezidenca”, bazohet në ligjin nr. 43/2023 “Për qeverisjen elektronike” dhe ligjin nr. 10325, datë 23.09.2010 “Për bazat e të dhënave shtetërore”. Konkretisht, projektvendimi parashikon se, regjistri elektronik, do të përbëhet nga të dhëna parësore dhe të dhëna dytësore, të cilat janë të dhëna personale.

Në këtë kuadër, Zyra e Komisionerit vlerëson se të gjithë palët e përfshira në këtë proces apo përpunim të dhënash, duhet të përmbushin kërkesat dhe detyrimet lidhur me garantimin dhe respektimin e të drejtës për mbrojtjen e të dhënave personale.

Sa i përket përmbajtjes së neneve konkrete, në pikën 4, të Kreut II “Procedurat e krijimit të regjistrit elektronik “E-Rezidenca”, bazë të dhënash shtetërore” parashikohet se: “Regjistri Elektronik “E-Rezidenca” ndërvepron me Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile (RKGJC), të vitit 2010”.

Sugjerojmë që kjo fjali të rishikohet nga ana juaj duke u plotësuar dhe saktësuar, në mënyrë që të përcaktohet lloji i ndërveprimit me RKGJC dhe niveli i aksesit në këtë bazë, në përputhje me qëllimin për të cilin po përpunohen këto të dhëna.

Në pikën 11, të Kreut të sipërcituar, sugjerojmë të shtohet fjalia me këtë përmbajtje:
“Në rastin kur sipas pikës 5, shtetasi i huaj heq dorë nga identiteti digjital “E-Residence”, IdentiTek sh.a., do të marrë masa për fshirjen e të dhënave biometrike.”.

Me përfshirjen e sa më sipër, projektvendimi, vlerësohet i hartuar konform legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

Besnik Dervishi